A.K.P.A.
Nr 2447 Prot.
Datë,më 02 10 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"**
**TIRANË**

**Nr.355/1/2 Prot** **Tiranë, më 30.09/2025**

**Lënda:** Njoftim për vend të lirë

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive",*Udhëzimit Nr.4,datë 18.08.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhezimin nr. 759, datë 30.09.2024" Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"*, shkolla e mesme profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

2 (dy) **Instruktor i teorisë profesionale për drejtimin "Hoteleri–Turizëm" profili Marketing & Logaritje kosto (kohë e pjesshme).**

**1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriterete përgjithshme për vend të si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Adresa: Rruga e Kavajes 50Tel/Faks: +355 4 232 0393 e-mail :hoteleriturizem_tirane@yahoo.com

**2.Aplikanti duhet të plotësojë kritere të posaçme si vijon**:

Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

a) të ketë të pakten diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme parauniversitare në të njëtën fushë me kualifikimin /kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin/cilat po aplikon;
b) të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit
d) preferohet të këte njohuri të gjuhës Angleze

**Dokumentet e aplikimit**

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
   a) Letër motivimin për pozicionin;
   b) jetëshkrimin (CV-në);
   c) kartën e identitetit;
   d) diplomën;
   e) librezën e punës;
   f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
   g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
   h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
   i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
   j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
   k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës ...09. 10. 2025

4. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar pëcaktimeve të Udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024 "Për mënyren e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, perberjes së njësise së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar

**DREJTORE**

**ELONA QEHAJAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI TURIZEM" - TIRANË

Adresa: Rruga e Kavajes 50 Tel/Faks: +355 4 232 0393 e-mail :hoteleriturizem_tirane@yahoo.com